



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme – Ministarstvo Inostranih Poslova – Ministry of Foreign Affairs

Ambasada e Republikës së Kosovës në Francë – Embassy of the Republic of Kosovo in France -

Ambassade de la République du Kosovo en France

K O N K U R S

Për pozicionin vakant:

Pozita: Vozitës
Vendi i punës: Ambasada e Republikës së Kosovës në Paris, Francë
Kohëzgjatja e kontratës: Një vit (me mundësi rinovimi) me tre muaj periudhë provuese.
Periudha e aplikimit: 15 – 30 nëntor 2017

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Ambasadorit/Shefit të Misionit, kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- Ofron shërbime të vozitjes për Ambasadorin/Shefin e Misionit, zyrtarët diplomatik/konsullor ose anëtarët tjerë të stafit sipas nevojës.
- Bën mirëmbajtjen e makinave të Ambasadës dhe kryen riparime të thjeshta të tyre.
- Ofron vozitje zyrtare gjatë mbrëmjeve, fundjavëve ose gjatë vizitave zyrtare të delegacioneve nga Kosova.

Përveç kësaj, ai/ajo duhet të kryejë edhe këto detyra:

- Kryen funksione rutinore të postës dhe korrierit.
- Kryen shpërndarjen dhe regjistrimin e postës diplomatike.
- Transporton mallra dhe materiale të tjera të zyrës.
- Mban shënime mbi kilometrazhin e automjeteve, riparimet, licencat, si dhe dokumentacionin tjetër.
- Bën prokurimin e furnizimeve për Ambasadë, Shërbim konsullor ose rezidencë zyrtare.
- Ndhmon Shërbimin konsullor të Ambasadës në mbajtjen e rendit të pritjes të palëve konsullore.
- Kryen detyra të tjera që zakonisht i caktohen asistentit administrativ/asistentit ekzekutiv, sipas kërkesës së Shefit të Misionit.

Kriteret dhe kushtet e kërkuara:

- Shkalla e arsimit të mesëm.
- Shtetësia e Kosovës (me lejeqëndrim të Francës), Francës, ose ndonjë vendi të tretë (me lejeqëndrim të Francës).
- Njohuri të mira të gjuhës frënge dhe njohuri të dëshiruara të gjuhëve zyrtare të Kosovës.
- Shkathtësi të certifikuara të vozitjes, duke përfshirë posedimin e patentë shoferit të vlefshëm në Francë dhe një histori të ngasjes së sigurt (mungesa e aksidenteve në të kaluarën).
- Shkathtësi të shkëlqyera të vetëorganizimit dhe punës administrative, dhe aftësi për të punuar nën presion (me afate të ngushta).
- Tre vjet përvojë pune relevante.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- CV;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopje të kualifikimeve/diplomave;
- Dy referenca të punës të kohëve të fundit dhe një letër motivimi;
- Certifikata mjekësore;
- Certifikatë që konfirmon se aplikuesi nuk është nën hetim nga autoritetet franceze.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në Ambasadën e Kosovës në Francë (7 rue de Monceau, 75008 Paris) ose nëpërmjet e-mail adresës: embassy.france@rks-gov.net.

Dokumentet e dërguara nuk do të kthehen.